

## **"E Drejta për Informim - Hapje, Transparencë, Digjitalizim"**

E nderuar zonja Felaj,

I nderuar Zoti Dervishi,

### **Të nderuar pjesëmarrës**

Padyshim, zoti Dervishi që ky vit që po lini pas ishte një vit plot rëndësi, duke shënuar **vitin e pesëmbëdhjetë të aktivitetit tuaj si një instisticion "Garancie të mbrojtjes së të dhënave personale."** Kjo është një periudhë relativisht e shkurtër për njeriun, dhe një periudhë edhe më e shkurtër për një institucion. Megjithatë, në një hark kaq të shkurtër kohor kultura e mbrojtjes së të dhënave personale ka zënë vend në shoqëri tonë në një masë të madhe.

Si çdo e drejtë e njeriut, e drejta për informim u përket të gjithëve. Kjo përfshin personat fizikë (shtetas shqiptarë, të huaj, si dhe pa shtetësi), personat juridikë, organizatat e shoqërisë civile.

E drejta për informim është një nga shtyllat kryesore të një shoqërie të hapur dhe demokratike. Në Shqipëri ka patur hapa vigane në drejtim të forcimit të hapjes, transparencës, lloagaridhenies, digjitalizimit si dhe ne te drejtën për informim.

Ne vitin që lamë pas shtrirja e inovacionit teknologjik, ishte shumë dimensionale dhe te thujse gjitha shërbimet tona publike si për qytaret dhe bizneset u ofruan vetëm on line. Realiteti i krijuar tashmë nga inovacioni teknologjik dhe revolucioni në rrjet, krijoi lidhje të tilla që njerëzit dhe gjërat të kthehen në rrjedha informacioni dhe të krijojnë marrëdhënie që konsistojnë vetëm në shkëmbimin e të dhënave.

Gjithashtu ky vit ishte viti që Shqipëria njohu dhe ratifikoi dy konventa të Keshillit të Europës që lidheshin me mbrojtjen e të dhënave personale.

Ne këto kushte detyra juaj po merr një rëndësi gjithnjë e më të madhe. Sigurimi i mbrojtjes adekuate të të dhënave po dëshmohet dita ditës si një parakusht gjithnjë e më thelbësor që demokracia të funksionojë dhe të drejtat dhe liritë themelore të realizohen.

Marrja e garancive se të dhënat tona janë të mbrojtura si përpara, por edhe kur shkëmbehen në rrjet, është thelbësore për të parandaluar që teknologjitë e reja të shndërrohen në një kërcënim.

Ndaj edhe për ju pjesë e rëndësishme e punës mbetet përhapja e një "kulturë inovacioni" të vërtetë – në mënyrë që askush të mos rrezikohet të bëhet pa vetëdije një mjet në duart e atyre që organizojnë dhe menaxhojnë teknologjitë e reja.

Prandaj dhe teknologjitë e reja, duhet të ecin paralelisht me hartimin e akteve ligjore dhe nenligjore të tilla që të behen mburojë e të drejtave dhe mbrojtjes së të dhënave personale që me tepër në një kohë si kjo e sotmja, ku Shqipëria ka hyrë në rrugën e integritit evropian. Në këtë proces të integritit, përafrimim me standardet dhe Acquis përben një pjesë të rëndësishme të punës sonë dhe ndaj ju po rivizitoni sot ligjin të mbrojtjes së të dhënave për ta përparuar sa më shumë me realitetin tonë. Mendoj se eksperiencia dhe ekspertiza e krijuar në këto 15 vjet pune të mirëfillte profesionale, do ju shërbejnë për t'ia dë me suksesë këtë sipërmarrjeje.

**Insitucioni juaj ka krijuar tashme traditen e mire te raporteve vjetore qe pasqyrojne punen e administrates publike ne pergjithesi, si deshmi jo vetem te arritjeve por edhe te autokorrektimit.**

Keto raportime kane nje perdorim pertej rrejtit tuaj, ata i sherbejne nje publiku me te gjere, dhe fakti qe ju keto monitorime i kryeni sipas metodologjive te platformave EU, ju bene nje institucion me reputacion te mirenjohur, deshmi e te ciles eshte edhe vendimi per mbajtjen e konferencës botërore të Komisionerëve të Informimit (ICIC) në vitin 2024 ne Tirane.

**Hapja dhe transparencja e institucioneve publike te cilin ju monitorini, sot eshte bere me elehte fale perdorimit te mjeteve digjitale dhe regjistrave digjitale, te cilet mundesojme edhe llogaritjen e statistiave per plot 221 institucione te perfshira ne platforme.**

**Keto institucione nga ana tjeter kane rritur shkallen e informimit te publikut nepermjet publikimit i dokumenteve zyrtare dhe raportet e financave mujore ne faqet e tyre eeb, duke bere keshtu hapa te medha drejt transparencës.**

**Transparenca e proceseve të vendimmarrjes:** Në përpjekjen për të forcuar hapjen, transparencën dhe gjithëpërfshirjen, qeveria shqiptare ka bërë progres në modus operandi të përfundimit të feedback në proceset e vendimmarrjes. Publikimi i projektligjeve online, konsultimet publike, këshillimi kombëtar, platforma e bashkeqeverisjes dhe përfshirja e shoqërive civile në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet mekanizmave të ndryshme sic është Komiteti Shumëpalësh për Qeverisje të Hapur dhe Këshillimi Kombëtar, promovohet dialogu mes palëve të interesuara mbi politikën e hapura të qeverisë, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve.

**Konsultimi publik** është mekanizmi që mundëson përfshirjen e publikut, në vendimarrje duke siguruar përfshirjen e tyre gjatë gjithë procesit të politikë-bërjes, me qëllim krijimin e politikave me cilësi të lartë në përmbajtje, që mundësojnë zgjidhje afatgjata dhe sigurojnë zhvillim. Shqipëria konsiderohet si vend pararojë në rajon lidhur me proceset e konsultimit publik dhe vlerësimin e ndikimit rregullator, duke performuar mbi mesataren e rajonit bazuar në raportin e Monitorimit të SIGMA 2021 mbi “Principet e Administratës Publike”.

Ka një vëmendje në rritje ndaj hapjes dhe transparencës së politikë-bërjes, si në nivelin global ashtu edhe atë rajonal, në kuadër të “**Partneritet për Qeverisje të Hapur**” (OGP) dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimarrje. Në planin kombëtar të veprimit për vitet 2023 – 2025 janë parashikuar **24** angazhime të rëndësishme në adresim të sfidave të PQH-së në vend.

Informacioni dhe liria për të patur akses në të është aspekt kyç i shoqërisë moderne. Në një shoqëri të tillë ku qytetarët kanë qasje të lirë ndaj informacionit, ku marrin përgjigje të drejtpërdrejtë nga institucionet publike nëpërmjet digjitalizimit të proceseve dhe kanë mundësinë të jenë pjesë e procesit të vendimmarrjes, krijohet klima e besimit dhe ajo e përgjegjësisë ndërmjet qytetarëve dhe qeverisë.

Megjithatë, për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm për të drejtën e informimit dhe transparencën, është e nevojshme një angazhim nga të gjithë ne. Institucionet, organizatat e shoqërisë civile dhe palë të tjera të interesuara duhet të punojmë të koordinuar për të përmirësuar ligjshmërinë, të rrisim vetëdijen publike dhe të ndërtojmë kapacitete për të përçuar këto vlera.

Faleminderit!